



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 141, datë 23.07.2019

**PËR
SHPALLJEN E VENDEVE TË LIRA
PËR GJYQTARËT E EMËRUAR MË DATË 19.07.2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 1, të nenit 39, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në konsideratë të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 15, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duke mbajtur parasysh numrin e gjyqtarëve të emëruar më datë 19.07.2019, pozicionet e lira në sistemin gjyqësor dhe numrin minimal të gjyqtarëve të përcaktuar nga ligji për gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 19.07.2019.
2. Vendet e lira për të cilat gjyqtarët e emëruar mund të aplikojnë janë si më poshtë:
 - a) një pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër;
 - b) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër;
 - c) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat;
 - ç) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;
 - d) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
 - dh) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës;
 - e) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin;

- ë) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
 - f) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë;
 - g) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë;
 - gj) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.
3. Gjyqtarët e emëruar kanë të drejtë të përcaktojnë, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.
 4. Gjyqtarët e emëruar duhet të deklarojnë për ekzistencën e lidhjeve të tyre familjare me magjistratë (gjyqtarë ose prokurorë) që ushtrojnë funksionet në gjykatat ose prokuroritë pranë gjykatave sipas pikës 2 të këtij Vendimi.
 5. Afati i aplikimit nga të emëruarit është deri më datë 26.07.2019. Mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve.
 6. Në momentin e aplikimit, gjyqtari i emëruar duhet të paraqesë këto dokumente:
 - a) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2, në të cilat kërkon të caktohet.
 - b) Një deklaratë me shkrim për ekzistencën e lidhjeve familjare me magjistratë (gjyqtarë ose prokurorë) që ushtrojnë funksionet në gjykatat sipas pikës 2 të këtij Vendimi.
 7. Dokumentacioni i gjyqtarëve të emëruar sipas pikës 6 të këtij Vendimi duhet të dorëzohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR